

E DREJTA PËR INFORMIM



15 vjet Zyra e Komisionerit, Konferenca V Kombëtare “E Drejta për Informim – Hapje, Transparencë, Digjitalizim”.

“15-vjet Zyra e Komisionerit, Konferenca V Kombëtare “E drejta për informim – Hapje, Transparencë, Digjitalizim”, ishte aktiviteti i zhvilluar nga institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Zyrën e Këshillit të Evropës (KiE) në Shqipëri.

Ky takim i rëndësishëm, me pjesëmarrjen e mbi 150 përfaqësuesve të autoriteteve publike qendrore e të varësisë, të pavarura, të sistemit të drejtësisë apo të vetëqeverisjes vendore, kishte në fokus vlerësimin e nivelit të zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Të ftuar nderi në këtë aktivitet, ishin znj. Ermonela Felaj Valikaj, Nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, znj. Milva Ekonomi, Ministër i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, z. Olsi Dekovi, Zëvendëskreu i Zyrës së Këshillit të Evropës dhe z. Sam Goldbart, Sekretari Parë i Ambasadës Britanike.

Komisioneri, z. Besnik Dervishi, theksoi në fjalën e tij se institucioni ka arritur të jetë funksional, i pavarur në vendimmarrje, laborator që performon dhe konkurren me kontributin e tij denjësisht në fushat e përgjegjësisë, e ndoshta dhe më gjerë. “Kjo veprimtari intensive përfshin edhe procesin e integritit evropian dhe atë në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, në dy prej të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të hapur dhe komunikues me publikun dhe që meriton të vendoset në pozicionin e duhur kushtetues dhe institucional. Duke besuar te ky luajalit,

Zyra e Komisionerit e ka ndërtuar strategjinë e punës së saj te edukimi dhe ndërgjegjësimi. Ne besojmë fort se, rregulli është transparenca, kufizimi i informacionit është përjashtim nga ky rregull.” Në fjalën e saj përshëndetëse, znj. Felaj, vlerësoi se “edhe pse institucion ende i ri, me një histori të shkurtër 15-vjeçare, Komisioneri ka krijuar tashmë një bilanc të pasur dhe po kontribuon për të kultivuar një kulturë të re për transparencën e autoriteteve publike. Me punë, kontribut, performancë profesionale e dinjitet, institucioni ka zënë vendin e tij të rëndësishëm në kontekstin e insitucioneve të pavarura, si gardianë të interesit publik dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve”. Në fjalën e saj, znj. Ekonomi theksoi se “insitucioni juaj ka krijuar tashmë traditën e mirë të raporteve vjetore që pasqyrojnë punën e administratës publike në përgjithësi, si dëshmi jo vetëm e arritjeve, por edhe të autokorrigjimit. Jeni një institucion me reputacion të mirënjohur, dëshmi e të cilës është edhe vendimi për mbajtjen e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) në vitin 2024 në Tiranë.”Për z. Dekovi “Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në miratimin e standardeve të përparuar ligjore në fushën e të drejtës për informim. Ratifikimi i Konventës së Tromsøs është një hap thelbësor për të rritur legjitimitetin e autoriteteve publike, duke nxitur integritetin, efikasitetin, efektivitetin dhe llogaridhënien e tyre, duke promovuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimet që ndikojnë në të ardhmen tonë të përbashkët.”

Konventa 205 e Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare” dhe projekti me Ambasadën e Britanisë së Madhe në Tiranë.



Një hapësirë në punimet e konferencës i kushtua Konventës 205 të Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare” dhe projektit të Zyrës së Komisionerit me Ambasadën e Britanisë së Madhe në Tiranë.

Me shumë interes nga të pranishmit u ndoq prezantimi i ekspertit të KiE, z. Cesare Pitea, i cili diskutoi mbi risitë e Konventës 205 “Për aksesin në dokumente zyrtare” (njohur ndryshe si Konventa e Tromsos), akt që ka vendosur standarde bashkëkohore në këtë fushë jo vetëm për hapësirën evropiane.

Në këtë Konferencë iu kushtua vëmendje edhe bashkëpunimit mes Zyrës së Komisionerit dhe Ambasadës Britanike në realizimin me sukses të projektit “Përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë së qeverive të Ballkanit Perëndimor përmes zhvillimit të komunikimeve efektive strategjike”, që u prezantua nga znj. Vasilika Laçi.

Për më shumë informacion rreth këtij aktiviteti mund të klikoni [këtu](#).



Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit qershor 2023.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit qershor 2023, ka dhënë 5 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit. Ndër to përmendim: Vendim Nr. 24 - Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Spitali Rajonal Berat; Vendim Nr. 25 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Vendim Nr. 26 - Bashkia Kamëz; Vendim Nr. 29 - Bashkia Kavajë; Vendim Nr. 30 - Bashkia Kavajë.

Lidhur me vendimin nr. 29, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës së depozituar nga ankuesi ndaj Bashkisë Kavajë me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi ka kërkuar informacion lidhur me: numri i pallateve të rinj, që janë planifikuar të ndërtohen në bashkinë tuaj?; Sa prej tyre janë përfunduar deri më tani?; Sa prej tyre janë në proces ndërtimi deri më tani?; Sa prej tyre nuk kanë nisur ende ndërtimin?; Kur planifikohet të përfundojë i gjithë programi?

Në mungesë të një përgjigje nga autoriteti publik, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar të drejtën e shkelur dhe ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit. Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit.

Zyra e Komisionerit nëpërmjet komunikimit zyrtar me Autoritetin Publik ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, në vijim të së cilës nuk pati një reagim nga ky autoritet. Pasi ka kontaktuar sërish autoritetin publik, Zyra e Komisionerit është informuar nga koordinatori për të drejtën e informimit se dokumentacioni i kërkuar nga ankuesi, është duke u përgatitur nga strukturat përkatëse të Autoritetit Publik, dhe do t'i komunikohet sa më shpejtë ankuesit. Megjithatë, Ankuesi ka informuar Zyrën e Komisionerit se: “..., ende nuk kemi një përgjigje nga Bashkia Kavajë...”, duke vijuar në këtë mënyrë ankimin. Në këto kushte, ekzistenca e informacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike. Bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Zyra e Komisionerit doli me vendim urdhërimi ndaj Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion.

Qendra Res Publica dorëzoi pranë Zyrës së Komisionerit ankesën me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kërkuar ka kërkuar informacion lidhur me: Cilat janë masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me rekomandimet e dhëna nga Avokati i Popullit me datë 21.05.2014?; A është miratuar një protokoll për trajtimin e pacientëve me “Hipertermi Malinje”, gjatë ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor?; Nëse po, ju lutemi na vini në dispozicion një kopje të protokollit të miratuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e ligjit për të drejtën e informimit. Ashtu si në rastin me Bashkinë e Kavajës, autoriteti publik në përgjigjen e tij tha se: informacioni i kërkuar ka qenë duke u përgatitur nga strukturat përkatëse të Autoritetit Publik dhe do t'i komunikohet sa më shpejtë kërkuarit. Në kushtet e mos marrjes së një përgjigjeje, ankuesi ka vijuar ankimin.

Në përfundim, Komisioneri doli me vendim urdhërimi ndaj autoritetit publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar nga ankuesi.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al

Forum për rolin e Zyrës së Komisionerit në promovimin e të drejtës për informim.

Me tematikën “E drejta e informimit në Shqipëri: vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, u zhvillua forumi për trajtimin e veprimtarisë institucionale nga këndvështrimi i studimeve akademike. Si nismë e mbështetur nga Zyra e Komisionerit, ky aktivitet u mbajt në kuadër të projektit të përbashkët të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), programit Ekspertiza Hulumtuese nga Diaspora Akademike (READ) dhe Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës. Në këtë forum ishin të pranishëm përfaqësues nga bota akademike, shoqëria civile, si dhe koordinatore për të drejtën e informimit të institucioneve qendrore e të pavarura.

Në fjalën e tij, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, vlerësoi nismën, duke theksuar domosdoshmërinë e nxitjes së projekteve të kësaj natyre në funksion të hapjes së autoriteteve publike. “Veprimtaria e Zyrës është udhëhequr nga promovimi i kulturës për respektimin e të drejtave të qytetarëve, si themel për një shoqëri demokratike, të zhvilluar, për institucione të përgjegjshme dhe transparente. Çdo kontribut që mbështet këtë frymë është i mirëpritur, nga bota akademike, organizata të shoqërisë civile apo grupet e interesit”.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMDP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDIMDP)